



Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	09 - 12 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Jednitca Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
521018/HUK	7866	2022	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.894/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.894/2022 të datës 12.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë:

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën me numër A.nr.984/2022 të datës 12.10.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën: "Zyrtare e Lartë e Personelit". E njëjta përmes Vendimit me numër protokollit 2446 të datës 01.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është transferuar përkohësisht në pozitën "Zyrtare e Lartë për Legalizimi dhe Çertifikim" pranë Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 01.07.2022 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 15.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshëm për shkak të mohimit të drejtave elementare të punës dhe mohimit të njoftimit paraprak. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.08.2022 nxjerr Vendim me numër A.nr.624/2022 me të cilin e aprovon ankesën e ankueses dhe e shfuqizon Vendimin me numër protokollit 2446 të datës 01.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me konstatimin se është nxjerre nga organi jo kompetent, në zbatim të Vendimit të Këshillit me datë 16.09.2022, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm e njofton ankuesen që të kthehet në Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore sipas Akt Emërimit.

Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Vendimit me numër protokollit 4133 të datës 07.10.2022 e transferon ankuesen përkohësisht nga pozita "Zyrtare e Lartë e Personelit" në pozitën "Zyrtare e Lartë për Legalizim dhe Çertifikim" në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 07.10.2022 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 12.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshëm, diskriminues dhe tendencioz .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar me datë 27.10.2022 për përgjigje në ankesë në MPJD. Këshilli, me datë 01.11.2022 përmes e-maili ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, kurse ankuesja me datë 09.12.2022 ka parashtruar kërkesë përmes emailit zyrtar lidhur me tërheqjen e ankesës së saj të datës 12.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.894/2022 të datës 12.10.2022 me numër protokollit 6097/2022 të parashtruar nga ankueses në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.ref.276/2022 i datës 07.10.2022 i Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; E-mail i datës 07.10.2022 Njoftim nga Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, drejtuar ankueses; E-mail i datës 03.10.2022 nga ankuesja drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; E-mail Njoftim i datës 19.09.2022 nga ankuesja drejtuar E-mail i datës 16.10.2022 nga zyra e Sekretarit të MPJD drejtuar ankueses, Njoftim; Vendim i datës 30.08.2022 i KPMSHCK-së me numër Anr.624/2022; Vendim Nr.Ref.219/2022 i datës 01.07.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm i MPJD-së; Formular i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 07.10.2021; Formular i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 19.10.2020; Formular i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 30.09.2019; CV-ja e ankueses; Vendim Nr.ref.77/2020 i datës 22.07.2020; i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së për caktimin e zëvendësimit; Vendim nr. Ref.120/2019 i datës 23.09.2019 mbi caktimin e ushtruesit të detyrës; Vendim nr. Ref.25/2022 i datës 10.05.2022 për caktimin e nëpunëses civile për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit; Akt emërimi i datës 13.06.2022 për ankuesen; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit Nr.029/2013 i datës 10.06.2013 për ankuesen; Akt emërim i datës 20.07.2012 për ankuesen; Kontratë e punës e ankueses nr. 133/2009 e datës 01.07.2009; Kontratë e punës e ankueses nr.216/2011 e datës 30.06.2011; Vendim Nr. Ref.792/2018 i datës 10.09.2018 ankueses i jepet grada diplomatike Sekretar i dytë; Vendim i datës 30.12.2015 me Nr.Ref.108/2015 grada diplomatike Sekretar i tretë; Përgjigje në ankesë e datës 01.11.2022 me nr. Protokollit 6606/2022 nga Njësia e personelit të MPJD-së; Flete thes e datës 01.09.2022 lidhur me vendimin Anr.624/2022 të KPMSHCK-së; E-mail i datës 01.11.2022 Njoftim nga Zyra e Sekretarit të MPJD për z.D.Ç dhe i datë 16.09.2022 drejtuar ankueses, lidhur me zbatimin e vendimit Anr.624/2022 të KPMSHCK-së; E-mail i datës 05.10.2022 nga ankuesja drejtuar Zyrës së Sekretarit MPJD dhe z.V.B, kërkesë për shpallje të konkursit; E-mail i datës 05.09.2022 kërkesë për aprovim, nga zyra e Sekretarit të MPJD drejtuar z.V.B; Dëshmi për pushim i datës 23.09.2022 nga ankuesja; E-mail Njoftim i datës 07.10.2022 nga z.V.B, drejtuar ankueses; Vendim Nr. Ref.276/2022 i datës 07.10.2022 për transferim të përkohshëm; Përshkrim i detyrave të punës sipas konkursit për pozitë zyrtar i lartë për legalizim dhe certifikim i datës 14.04.2015; Akt emërim AE.NR.07/2022 i datës 13.06.2022; kërkesë e datë 09.12.2022 e ankuese përmes emailit zyrtar për tërheqjen e ankesës së saj të datës 12.10.2022'

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga

palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.894/2022 të datës 12.10.2022 e parashtruar nga ankuesja

sepse:

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, konststton se ankuesja me datë 12.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6097/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 09.12.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 7818/2022 për tërheqje të ankesës me numer A.nr.894/2022 të protokolluar me numër 6097/2022 të datës 12.10.2022 me arsyetimin se: *Duke iu referuar ankesese se dates 12.10.2022 per ritransferim ne në pozitën "Zyrtare e Lartë për Legalizim dhe Certifikim të datës 07.10.2022 të nxjerr nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore më lejoni t'ju njoftoj se tërhiqem nga Ankesa marr parasysh faktin se tanimë po thuj se është konsumuar periudha 6 muajore që nga transferimi im, periudhë kjo e cila përfundon me datën 31 dhjetor 2022"*.

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstatoj që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën me numër A.nr.894/2022 të datës 12.10.2022 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.894/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.